



Komuna Vushtri

Nr.Ref.....

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	578 / 18
Nr. i fq. / Br. sht	
Data / Datum	26.04.2018
VUSHTRRI - VUČITRN	



Shoqata SAB

MARRËVESHJE GRANTI

në mes

Shoqatës “Sveriges Albanska Brudar”

dhe

Komunës së Vushtrrisë

Shoqata humanitare “Sveriges Albanska Brudar” me seli në Suedi, përfaqësuar nga katër vajza: Arta Krasniqi, Lindita Bajrami, Kadrije Gërguri, Ilirjana Asani në vijim referuar si Shoqata Humanitare “Sveriges Albanska Brudar”,

nga njëra anë, dhe

Komuna e Vushtrrisë, sheshi „Hasan Prishtina”, nr.173 42000 Vushtri, e përfaqësuar nga z. Xhafer Tahiri - kryetar i komunës (në vijim referuar si “Përfitues”),

në anën tjetër.

Duke iu referuar projektit të fondit humanitar për renovimin e shkollës “Bahri Haxha” në Vushtri dhe thirrjes për shprehje interesi, e bërë më 21 shkurt 2018, kanë rënë dakord si më poshtë:

NENI 1

QËLLIMI I MARRËVESHJES

1. Fondi humanitar “Sveriges Albanska Bruder”, sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje dhe në shtojcat e saj, ndan shumën prej **9.000 € (nëntë mijë euro)** për zbatimin e projektit “Rregullimi i shkollës Bahri Haxha në Vushtri”.

2. Përfituesit duhet të zbatojnë projektin e propozuar.

NENI 2

DETYRIMET E SHOQATËS "SVERIGES ALBANSKA BRUDER"

- 1.1. Shoqata "Sveriges Albanska Bruder" do të paguajë shumën e përmendur në nenin 1 në një këst, brenda 15 ditësh pas marrjes së kësaj marrëveshjeje të nënshkruar rregullisht;
- 1.2. Pagesa do të bëhet në euro;
- 1.3. Shuma e sipërpërmendur do të paguhet me vetëm transferim bankar në llogarinë e mëposhtme të hapur në emrin e përfituesit:

Zotëruesi i llogarisë: Komuna e Vushtrrisë,
Numri i plotë i llogarisë bankare: 1000650310000041,
Kodi i IBAN-t,
Kodi i SWIFT: CBRKXXKPRXXX,
Emri i Bankës: Banka Qendrore e Kosovës,
Adresa e bankës: Rr. "Garibaldi", Prishtinë, Republika e Kosovës.

NENI 3

DETYRIMET E PËRFITUESIT

1. Përfituesi duhet:
 - 1.1 Të jetë përgjegjës për zbatimin e projektit, në përputhje me afatet dhe kushtet e marrëveshjes;
 - 1.2 Të jetë përgjegjës për respektimin e çdo detyrimi që i takon;
 - 1.3 Të informojë Fondin humanitar "Sveriges Albanska Bruder" menjëherë për çdo ndryshim që mund të ndikojë ose të vonojë zbatimin e projektit, për të cilin përfituesi ka dijeni;
 - 1.4 Të dokumentojë në bazë të fotove nevojën e renovimit të objektit, gjithashtu të dërgojë planin për renovimin e objektit;
 - 1.5 Të fillojë direkt renovimi pasi që përfituesi ka marrë mjetet e dërguara nga shoqata, dhe njëkohësisht të dërgohet raport javor tek shoqata.
2. Përfituesi merr përsipër:
 - 2.1 Të përdorë këtë grand ekskluzivisht për qëllimin e marrëveshjes, sikurse thuhet në nenin 1;
 - 2.2 Të mos nxjerrë asnjë fitim përmes grandit të Fondit humanitar "Sveriges Albanska Bruder";
 - 2.3 Menjëherë me marrjen e grandit t'i dërgojë Fondit humanitar "Sveriges Albanska Bruder" një raport përshkrues për përdorimin e tij dhe një raport përfundimtar përshkrues pas mbarimit të renovimit;
 - 2.4 T'i dërgojë Fondit humanitar "Sveriges Albanska Bruder" brenda një javë pas mbarimit të kontratës:

- 2.4.1 Një raport financiar në euro, për pagesat e bëra për projektin, të vërtetuara nga një punonjës përgjegjës i zyrës së financave (të përfituesit), shoqëruar me dokumentet e duhura origjinale¹ (dhe një përmbledhje të përkthyer të këtyre faturave në anglisht), ku, sipas ligjit të vendit, përfituesi duhet t'i ruajë dokumentet origjinale, dhe duhet dërguar kopje të vërtetuara së bashku me raportin përfundimtar;
 - 2.4.2 Një kopje të njoftim-kreditimit ose ndonjë dokument tjetër nga banka e përfituesit për të vërtetuar pagesën;
 - 2.4.3 Kur marrëveshja është bërë në monedhën e vendit, një kopje të vërtetuar, të lëshuar nga banka e përfituesit, ku vihet në dukje kursi i këmbimit i përdorur në datën e këmbimit të shumës së marrë në monedhën vendase.
3. Të mbajë llogaritë e projektit për një periudhë minimale dhjetëvjeçare nga data e dërgimit të raportit përshkrues dhe pasqyrave financiare sipas nenit 2.2, 2.3 dhe 2.4, për çdo verifikim tjetër të mëtejshëm të përdorimit të duhur të grantit që mund të bëjnë Shoqata "Sveriges Albanska Bruder", Gjykata Evropiane e Auditorëve, Këshilli i Evropës, auditorët e tij të jashtëm ose përfaqësuesit e caktuar prej tyre.

NENI 4 KOMUNIKIMI MIDIS PALËVE

1. Pika e kontaktit e Shoqatës humanitare "Sveriges Albanska Bruder" është:
znj. Arta Krašniqi, njëra nga udhëheqëset e shoqatës humanitare të projektit "Rregullimi i shkollës Bahri Haxha Vushtrri".
Adresa: c/o Lindita Bajrami, Sveriges Albanska Bruder, Solskengsgatan 17,25473 Ödåkra
Telefoni: 07 22948260
Email: krasniqiarta@hotmail.com

Pika e kontaktit e përfituesit
z. Bashkim Kovaçi, Drejtor i SHMLP „Bahri Haxha”, Vushtrri
Adresa: Rruga „Ukshin Kovaçica”, 42000 Vushtrri/Republika e Kosovës
Telefoni,+383(0)44 979 749
Email: bashkkova@hotmail.com
2. Çdo komunikim gjykohet se është bërë kur është marrë nga pala pritëse, përveçse kur marrëveshja i referohet datës kur është dërguar komunikimi.
3. Komunikimi elektronik konsiderohet se është marrë nga pala pritëse në datën e dërgimit të suksesshëm të atij komunikimi, me kusht që ai të dërgohet në adresat e renditura në paragrafin 1 të cekur më lart. Dërgimi do të konsiderohet i pasuksesshëm nëse pala dërguese merr një njoftim se mesazhi nuk ka shkuar. Në këtë rast pala dërguese duhet menjëherë t'i dërgojë përsëri një komunikim të tillë secilës nga adresat e tjera të renditura në paragrafin 1 të sipërcekur. Në rast dërgimi të pasuksesshëm, pala dërguese nuk do të quhet përgjegjëse për shkelje detyrimi për ta dërguar komunikimin brenda afatit të specifikuar, me kusht që komunikimi të dërgohet me një mjet tjetër komunikimi pa vonesa tjera.

4. Korrespondenca që i dërgohet Fondit humanitar "Sveriges Albanska Bruder" me anë të shërbimeve postare, konsiderohet se është marrë nga Fondi humanitar "Sveriges Albanska Bruder" në datën në të cilën është regjistruar nga departamenti i përcaktuar në paragrafin 1 më lart.
5. Njoftimi zyrtar i bërë me postë-rekomandë me mandat dorëzimi apo me një dokument të barasvlershëm ose me mjete të barasvlershme elektronike, që do të konsiderohet se është marrë nga pala marrëse në datën e marrjes së shënuar në mandat dorëzimi apo në një dokument të barasvlershëm.

NENI 5 PËRGJEGJËSIA PËR DËMTIMET

Fondi humanitar "Sveriges Albanska Bruder" nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi për asnjë dëm të shkaktuar apo të pësuar nga përfituesi, duke përfshirë çdo dëm shkaktuar palëve të treta si pasojë gjatë zbatimit të projektit.

NENI 6 KONFLIKT INTERESI

1. Përfituesi angazhohet të marrë të gjitha masat mbrojtëse për të parandaluar një situatë ku zbatimi i paanshëm dhe objektiv i marrëveshjes komprometohet për shkaqe që kanë të bëjnë me interesa ekonomike, afërsi politike apo kombëtare, lidhje familjare apo emocionale ose ndonjë interes tjetër të përbashkët ("konflikt interesi").
2. Çdo situatë që përbën ose që ka të ngjarë të shpjerë në konflikt interesi gjatë zbatimit të marrëveshjes, i duhet bërë e ditur Fondit humanitar "Sveriges Albanska Bruder" me shkrim pa vonesë. Përfituesi duhet menjëherë të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për ta ndrequr këtë situatë. Fondi humanitar "Sveriges Albanska Bruder" i rezervon vetes të drejtën të verifikojë që të gjitha masat e marra, por mund të kërkojë edhe marrjen e masave shtesë brenda një afati të caktuar.

NENI 7 LLOGARITË, KONTROLLET TEKNIKE DHE FINANCIARE

1. Përfituesi duhet të mbajë evidenca dhe llogari të sakta dhe sistematike në lidhje me zbatimin e projektit, ku të gjitha faturat dhe pagesat duhet të detajohen.
2. Transaksionet financiare dhe pasqyrat financiare do t'u nënshtrohen procedurave të brendshme dhe të jashtme të monitorimit të përcaktuara me rregullore, rregullat dhe udhëzimet financiare të përdorura nga përfituesi.
3. Projekti do të mbikëqyret nga një komision i përbashkët, kurse pranimi teknik do të bëhet nga një komision tjetër i përbashkët.

NENI 8
RASTI I FORCËS MADHORE

1. Në rastin e ndonjë force madhore, palët do të lirohen nga marrëveshja pa asnjë kompensim financiar. Forca madhore përfshin si vijon: probleme të mëdha të motit, tërmete, zjarre apo gjendje lufte.
2. Në rastin e rrethanave të tilla, secila palë duhet të njoftojë palën tjetër, përkatësisht me shkrim brenda një periudhe prej pesë ditësh.

NENI 9
MOSMARRËVESHJET

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë marrëveshje, pas dështimit të një zgjidhjeje miqësore midis palëve, duhet të dërgohet në arbitrazh sipas Rregullit nr.481 të 27 shkurtit 1976, të nxjerrë nga sekretari i përgjithshëm me miratimin e Komitetit të Ministrave, sikurse që përcaktohet në nenin 21 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetin e Këshillit të Evropës.

NENI 10
KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe është e vlefshme deri në përfundimin e projektit.

Fondi humanitar "Sveriges Albanska Bruder"

Arta Krasniqi
Përfaqësuesja: Arta Krasniqi.
24/4-2018



Përfituesi: Komuna e Vushtrrisë

Xhafer Tahiri
Xhafer Tahiri - kryetar i komunës

Fondi humanitar "Sveriges Albanska Bruder"

Lindita Bajrami
Përfaqësuesja: Lindita Bajrami

Fondi humanitar "Sveriges Albanska Bruder"

Ilirjana Asani
Përfaqësuesja: Ilirjana Asani